



Energy Regulatory Office
Zyra e Rregullatorit për Energji
Regulatorni Ured za Energiju

Hamdi Mramori Street, No 1
Prishtina 10000 – Kosovo
Tel: +381 (0) 38 247 615 ext. 103
Fax: +381 (0) 38 247 620
e-mail: info@ero-ks.org
www.ero-ks.org

Prishtina, 18 Shtator 2006

Nga: **Dr Nick Frydas**
Kryesues i Bordit të
Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE)

Për: **Të nderuarin Ministër Haki Shatri**
MEF

Të nderuarin Ministër Et'hem Ceku
MEM

Znj. Chiara Brochi
Drejtoreshë e FAO

Kopja: **Z. Paul Acda**
ZPSSP Shtylla e IV

Z. Agron Dida
Zëvendës Ministër MEM

Znj. Pranvera Dobruna Kryeziu
Drejtoreshë Ekzekutive-KEK Sh. AJSC

Z. Fadil Ismaili
Drejtor Ekzekutiv– KOSTT

Dr. Ali Hamiti
Drejtor i Zyrës Rregullative KEK Sh. A

Znj Fëllënza Pula
KEK Sh. A Furnizimi

Z. Shefqet Avdiu
KEK Sh. A Gjenerimi

Z. Ibrahim Selmanaj
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

Znj. Lejla Uzicanin
Shtylla e IV e UNMIK-ut

Z. Ilir Salihu
Drejtor i AKM POE

Z. Gëzim Pula
Sekretar i Përhershëm, MEM

Z. Tom Sherwood
Bearing Point/MEM

Z. Thomas Bush
Shtylla e IV-të

Anëtarëve të Bordit të ZRRE-së

Lënda: Shqyrtimi i Çmimeve Elektrike – Ndikimi i kontributeve të BKK në Tarifat finale me Pakicë

Të nderuar,

ZRRE-ja tashmë është duke kryer Shqyrtimin e Parë të Çmimeve për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike për të përcaktuar të ardhurat e lejuara të tyre dhe aprovimin e tarifave për tu implementuar më 1 Janar 2007. Në dëgjimin publik më 12 Shtator, të ardhurat e propozuara të lejuara janë prezantuar për komente nga ZRRE-ja. (ju lutem shih tabelën e bashkëngjitur). Vendimet lidhur me të ardhurat e lejuara dhe tarifat e reja do të merren nga ZRRE-ja, më 29 Shtator respektivisht më 6 Nëntor 2006.

Qëllimi i kësaj letre është që të kërkojmë konfirmimin e disponueshmërisë së subvencioneve të BKK për Sh.A. KEK, për periudhën tre vjeçare të shqyrtimit të çmimeve duke filluar nga Janari 2007, veçanërisht për të mbuluar:

1. Koston e humbjeve komerciale të distribucionit (poashtu të quajtura si jo-teknike) bazuar në nivelin e caktuar (të para specifikuar) të humbjeve;
2. Koston e faturave të pa-arkëtuara nga Furnizimi Publik i KEK-ut, prapë e vlerësuar sipas një niveli të caktuar;
3. Koston e energjisë elektrike të importuar; dhe
4. Subvencionet për konsumatorët e varfër.

ZRRE-së i nevojiten informata për tre artikujt e parë më lartë për të përcaktuar të ardhurat e lejuara.

Humbjet Komerciale dhe humbjet nga jo-arkëtimi

Niveli i humbjeve komerciale (që rezultojnë nga lidhjet ilegale, njehsorët e parregullt, njehsorët e ngatërruar - të manipuluar) në Kosovë, edhe pse kanë tendencë të rënies, janë akoma shumë të larta; humbjet komerciale për vitin 2006 pritet të jenë afër 31% të energjisë së matur në hyrje të sistemit të distribucionit. Metodologjia e Tarifave e nxjerrë nga ZRRE-ja i jep Distribucionit të KEK-ut një nxitje që t'i zvogëlojë edhe më tej këto humbje. Nën këtë Metodologji, Distribucionit të KEK-ut do të lejohet të mbulojë koston e blerjes së energjisë për të mbuluar një nivel të para-specifikuar të humbjeve komerciale, të caktuar njëjtë me një përqindje të planifikuar të energjisë të matur në hyrje të sistemit të distribucionit. Caqet e propozuara nga ZRRE-ja për vitin 2007 deri më 2009 prej 22% respektivisht 17% dhe 13%, të paraqitura në tabelën më poshtë, paraqesin reduktime të mëdha mbi nivelin ekzistues të humbjeve komerciale dhe bazohen në Planin e Rimëkëmbjes Financiare të KEK-ut.

Niveli i humbjeve nga jo-arkëtimi është poashtu i lartë: në vitin 2005, 67% e shumës së faturuar është arkëtuar. ZRRE-ja propozon që caku i nivelit të arkëtitimit do të rriten gjatë periudhës së shqyrtimit të çmimeve, prej 70% në vitin 2007 deri në 80% në vitin 2009 (caku i vënë sipas Strategjisë së Energjisë nxjerrë nga Ministria e Energjisë dhe Minierave), siç shihet në tabelën më poshtë. Pa marrë parasysh burimin (BKK, KEK-u apo konsumatorët pagues) e financimit të faturave të pa-arkëtuara, shfrytëzimi i cakut të vënë të arkëtitimit do t'i ofroj Furnizimit Publik të KEK-ut një nxitje për të përmirësuar nivelin e arkëtitimit.

Caku i Nivelit të Humbjeve dhe Kostoja e Blerjes së Energjisë

| Humbjet Komerciale të Distribucionit | <i>Njësia</i> | 2007 | 2008 | 2009 |
|---|---------------|-------------|-------------|-------------|
| Caku i humbjeve komerciale të distribucionit | % | 22 | 17 | 13 |
| Kostoja e blerjes së energjisë për humbjet komerciale | <i>M €</i> | 20.0 | 15.0 | 13.4 |
| Humbjet nga jo-arkëtimi | | | | |
| Caku i arkëtitimit <i>(Pjesa e të ardhurave të faturuara në vit)</i> | % | 70 | 80 | 80 |
| Kostoja e faturave të pa-arkëtuara <i>(supozon që konsumatorët nuk paguajnë për humbjet komerciale)</i> | <i>M €</i> | 32.1 | 21.1 | 27.1 |

Normalisht, nën regjimet tjera tarifore, kostoja e humbjeve komerciale dhe të humbjeve nga jo-arkëtimi, mbulohet prej të gjithë konsumatorëve. Sidoqoftë, pasi që nivelet e këtyre humbjeve janë të larta në Kosovë, ndikimi i kësaj në konsumatorë do të ishte shumë i madh; kostoja e kombinuar e financimit të humbjeve të caktuara komerciale dhe të jo-arkëtitimit në vitin 2007 vlerësohet të jetë **52.1 milion euro**, siç shihet në tabelën e mësipërme.

Pa përfshirë koston e këtyre humbjeve në tarifa, vlerësohet se tarifa mesatare shtëpiake në vitin 2007 është dashur të jetë afërsisht 4.4 €/kWh. Sidoqoftë, në mungesë të subvencionit për KEK-un për t'i mbuluar këto humbje, nuk do të është e mundur për KEK-un të financojë shpenzimet operative dhe investimet e veta nëse tarifa është caktuar në këtë nivel.

Vendosja e koston së humbjeve komerciale dhe të jo-arkëtitimit për konsumatorët pagues duke i bërë më të larta të ardhurat e lejuara të KEK-ut për kompensimin e këtyre do të rezultonte në rritjen e mesatares së vlerësuar të tarifës për amvisëri deri në 7.3 €/kWh, siç shihet në bashkëngjitjen e kësaj letre. Ky nivel tejkalon vlerësimin e ZRRE-së për tarifë të përballueshme të energjisë elektrike (rreth 5.7 €/kWh). Kjo poashtu i ngrit çështjet lidhur me ndershmërinë që konsumatorët pagues të energjisë elektrike t'i mbulojnë (të paguajnë) koston e furnizimit të energjisë për konsumatorëve mos-pagues. Që të dyja tarifa e lart dhe padrejtësia e këtij aranzhimi do të mund të ngadalësoj përpjekjet e tanishme të KEK-ut për të reduktuar humbjet komerciale dhe për të përmirësuar normën e arkëtitimit.

Prandaj, zgjidhja e preferuar e ZRRE-së është të sigurojë subvencione në baza të rënies së çmimit për t'i mbuluar këto humbje për një periudhë gjersa KEK-u të përmirësojë performancën e vet. Duke i bazuar subvencionet në një nivel të caktuar të humbjeve, kërkesat nga BKK do të jenë fikse dhe të njohura paraprakisht gjersa për KEK-un do të mbetet nxitja për tu përpjekur që t'i arrij (madje edhe t'i tejkaloj) këto caqe. Aty ku furnizimi i KEK-ut arrin t'i arkëtoj borxhet

(humbjet nga jo-arkëtimi) në një periudhë më të vonshme prej konsumatorëve, kjo do të ndahej ndërmjet KEK-ut dhe BKK sipas Metodologjisë së Tarifave.

Subvencionet e lidhura me koston e importit të energjisë elektrike

Me qëllim që të mënjanohet llogaritja e dyfishtë gjatë kalkulimit të të hyrave të lejuara, ZRRE-së i duhet konfirmimi se a do të vazhdoj t'i ofrohet ndonjë subvencion Sh.A. KEK gjatë periudhës 3 vjeçare duke filluar nga viti 2007 për importin e energjisë elektrike. Kjo përfshinë çdo qasje në parat e subvencioneve të ofruara gjatë viteve të mëhershme dhe të pashpenzuara. Të hyrat e lejuara të paraqitura nga ZRRE-ja në dëgjimin publik të mbajtur me 12 shtator, dhe duke theksuar tabelat e përfshira në këtë letër, supozojnë se nuk do të ketë subvencione **të tilla**.

Subvencionet e Konsumatorëve të varfër

Momentalisht, Furnizuesi Publik KEK siguron shërbime pa pagesë për rastet e caktuara të regjistruara si raste sociale nga 500 kWh/muaj (kWh e parë në muaj) nga konsumimi i energjisë elektrike. Është e kuptueshme që MEF ka marr një buxhet të propozuar prej 4.6 milion euro nga AKM-ja për vitin 2007 për të mbuluar shpenzimet kjomë dalin nga financimi i kësaj skeme. ZRRE-së i duhet të dijë se a do të jenë në dispozicion këto fonde me qëllim që të aprovohet tarifa e re. Nëse fondet nuk do të jenë në dispozicion, ose skema do të duhej të financohet nga konsumatorët që konsumojnë shumë ose duhet të ndërpritet.

Koha

Konfirmimi për disponueshmërinë e fondeve do të duhej të bëhet deri me **25 shtator** me qëllim që ZRRE-ja të lëshoj vendimin për të hyrat e lejuara me **29 Shtator** 2006.

ZRRE-ja mbetet në dispozicion të Ministrive dhe të AQF-së për të organizuar një takim për të diskutuar më në detale çështjet e shtruara në këtë letër. Në çdo rast ju lutemi që lirisht të kontaktoni ZRRE-në për çdo pyetje ose koment që keni në lidhje me këtë letër.

Mbes në pritje të përgjigjes suaj. Kjo letër si dhe përgjigja në të do të publikohen në web-faqen e ZRRE-së.

Sinqerisht i juaj,

Dr Nick Frydas

Kryesues i Bordit

Dokumenti i Bashkangjitur: Tarifa Mesatare (€cent/kWh; 2006 çmimet; pa TVSH)

| Supozimet – a paguan konsumatori për: - Humbjet jo-teknike në Distribucion? - Koston (humbjet) e mos-arkëtimit? | Tarifa e vlersuar Mesatare | | |
|---|----------------------------|-------|-------|
| | 2007 | 2008 | 2009 |
| | €/kWh | €/kWh | €/kWh |
| Scenario 1: Konsumatori nuk paguan për humbjet jo-teknike të distribucionit | | | |
| 1a – Konsumatori nuk paguan për faturat e pa-arkëtuara | 4.4 | 4.2 | 4.4 |
| 1b – Konsumatori paguan për faturat e pa-arkëtuara, niveli i vlerësuar i pagesës: 70%; 80%; 80% | 6.2 | 5.3 | 5.5 |
| Scenario 2: Konsumatori paguan për humbjet jo-teknike të distribucionit (në një nivel të caktuar) | | | |
| 2a – Konsumatori nuk paguan për faturat e pa-arkëtuara | 5.2 | 4.8 | 4.9 |
| 2b – Konsumatori paguan për faturat e pa-arkëtuara, niveli i vlerësuar i pagesës: 70%; 80%; 80% | 7.3 | 6.0 | 6.1 |